

Allahu, subhanehu ve teala, u ka dhënë robërve të vet shembuj dhe dëshmi të ndryshme nga jeta e përditshme, për Njëshmërinë e Tij subhanehu ve teala. Këto dëshmi tregojnë për Fuqinë dhe Mjeshtrinë e Allahut, subhanehu ve teala, në krijimet e Tij si dhe ofrojnë një pasqyrë të mrekullueshme të llojllojshmërisë biologjike.
Ky demonstrim i Fuqisë së Allahut, subhanehu ve teala, është e vërteta absolute e Krijimit.

Allahu, subhanehu ve teala, në Kur'an thotë:
**"Për besimtarët ekzistojnë argumentet në qiej dhe në tokë". (Xhathije: 3)**

Në vazhdim do të flasim për agjërimin e kafshëve. Sado që duket e pabesueshme, ajo është një praktikë reale që kafshët pandërprerë e zbatojnë.

## AGJËRIMI I KRIMBAVE TË MËNDAFSHIT

Edhe pse dihet mirë se ushqimi është ndër faktorët e rëndësishëm për rritjen dhe zhvillimin e organizmave të gjallë, krimbat e mëndafshit dëshmojnë se agjërimi dhe abstenimi i plotë nga ushqimi dhe pija, nuk e dëmtojnë trupin. Agjërimi, këto krijesa i riformon dhe i zhvillon në mënyrë të habitshme. Që të kuptojmë sekretet e këtij lloji të agjërimit, së pari duhet të përmendim disa fakte për jetën e kësaj krijese.

Në fillim të pranverës, vezët formojnë një larvë të vogël dhe të ngjeshur. Larva e sapokrijuar fillon të ushqehet me gjethe për pesë ditë. Kështu, trupat e tyre rriten aq shpejtë sa që lëkura e tyre nuk mund ta durojë këtë zhvillim të shpejtë, dhe kështu ndërrohet me një lëkurë të re. Për këtë shkak ato duhet të agjërojnë një ose dy ditë deri sa trupi i tyre të adaptohet për ta larguar lëkurën e vjetër. Ky process ndodh pesë herë gjatë periudhave të hershme, para kompletimit të këtij ndryshimi të formës (metamorfozës) që zgjat rreth 30 ditë. Pas kësaj ato kompletojnë shkallën e zhvillimit dhe arrijnë një madhësi të dukshme.

Kur larva arrin këtë madhësi, ajo hyn edhe në një lloj tjetër të agjërimit që zgjat deri më 6 ditë. Ajo strehohet në një vend të qetë për të gendisur mbulesë për këtë periudhë. Është shumë interesante se larva formon vetëm një fije të fortë dhe të shkëlqyeshme që mund të arrijë gjatësi prej 400 deri 1200 metra. Kjo mbulesë quhet fëshikëz, që është burim i mëndafshit që njerëzit aq shumë duan ta mbajnë (ta veshin).

Në këtë periudhë krimbi ka hyrë në gjendje të mos ngrënies, gjatë së cilës larva kalon nëpër transformim të përgjithshëm brenda fëshikëzës mbrojtëse. Gjatë kësaj gjendje krimbi ka nevojë për qetësi të madhe. Kjo është një gjendje e rëndësishme në jetën e këtyre insekteve të mrekullueshme, gjatë së cilës ndodhin transformime të shpejta dhe të njëpasnjëshme. Pas kësaj, insekti përgatitet të kalojë edhe në një formë tjetër.

Krimi që agjron shndërrohet në gjigant rebel që shkatërron mbulesën për të dalë jashtë. Ai lëshon një lëng që shkrin një pjesë të fëshikëzës, që pastaj prodhon organizmin e mrekullueshëm të quajtur krimbi i mëndafshit dhe që lëshon vezët pas fekondimit. Pastaj vezët në pranverë do të çelin dhe kështu do të kalojnë nëpër të njëjtin cikël të jetës. Lavdi qoftë Allahut, Krijuesit, Rregulluesit, Ndreqësit!

## AGJËRIMI I BRUMBUJVE

Për çudi nga llojet e insekteve në botë, brumbujt sikur duan ta kalojnë dimrin në maje të maleve, në temperatura jashtëzakonisht të ftohta. Menjëherë pasi ta hetojnë të ftohtin e ajrit dhe afrimin e dimrit, ata nisen me shpejtësi drejt majave të maleve.

Dihet mirë se majat e maleve nëpër vendet evropiane janë vende shumë të ftohta, vazhdimisht të mbuluara me borë dhe në temperatura prej rreth 30 gradë e më shumë nën zero.

Pa dyshim se temperaturat kaq të ftohta ndikojnë në këto insekte, në kuptim të dobësimit të tyre dhe nevojës më të madhe të energjisë, por trupat e tyre janë të mbushura me substancë të yndyrshme nga të cilat ato varen gjatë gjith kohës së gjumit dimëror dhe agjërimit. Kjo energji e tepërt do t'ju ofrojë atyre ngrohtësi, sidomos në ditët e fundit të dimrit, kur rezervat e ushqimit fillojnë të pakësohen.

Këtu paraqitet një pyetje: Çka ndodh me ato insekte të cilët nuk e kanë kohën ta prishin agjërimin? A e prishin edhe ato agjërimin kur janë në gjendje kritike, apo Allahu u jep atyre mënyra tjera për ta tejkaluar atë?

Kuptohet se Allahu Fuqiplotë, i Cili i ka krijuar të gjitha krijesat e Tij në mënyrë aq të përsosur, se çdo krijesë të Tij e ka pajisur me mjete të nevojshme për të jetuar një jetë të kënaqshme. Kështu, Allahu nuk i le vetë as këto krijesa. Gjatë migrimit të këtyre insekteve nëpër majat e maleve, në brendi të trupave të tyre ndodh një proces i rëndësishëm dhe i çuditshëm. Gjatë kësaj periudhe, ato hanë pandërprerë dhe mbledhin ushqime të ndryshme të cilat i vendosin në trup në forma të yndyrave. Gjatë kësaj ato nuk pijnë aspak ujë. Kështu, uji që gjendet në trupat e tyre merr një formë tjetër - bëhet ujë i ngjeshur. Ky lloj i ujit, disa substanca ushqyese i shndërron në forma edhe më të ngjeshura të ujit. Ky proces është shumë i rëndësishëm për këto insekte, për shkak se u mundëson atyre të ballafaqojnë me sukses temperaturat e ulëta dimërore. Si rrjedhë e kësaj, uji që gjendet në trupat e tyre nuk ngrihet kur temperaturat ulen nën zero.

Nëse temperaturat ulen jashtëzakonisht shumë, sa që nuk mund të durohen, Mëshira e Allahut me këto krijesa u jep atyre edhe një karakteristikë çuditshme.

Për mrekulli, kjo u mundëson atyre të përfitojnë një energji të ngrohtë nëpërmjet ujit që gjendet në trupin e tyre, që ka një temperaturë të zakonshme të ujit. Nëse temperatura bie në 30 gradë nën zero, insektet lirojnë energjinë e ujit dhe kështu, temperatura e trupit të tyre normalizohet.

**AGJËRIMI I MARIMANGAVE**

Në botë ekzistojnë shumë lloje të marimangave. Ato kanë nga tetë këmbë, dy orientues ose antenna, dhe një bark të madh që mban disa tjerëza që prodhojnë strofulla, fëshikëza, ose rrjete për t'i zënë në kurth insektet. Marimangat kanë nga 6 ose 8 sy në pjesën e epërme të trupit të tyre.

Kur'ani Famëlartë ka një sure të quajtur "Ankebut" që do të thotë "Marimanga". Në të Allahu subhanehu ve teala thotë:

**"Shembulli i atyre, të cilët veç All-llahut morën mbrojtës (zota idhujsh), është si shembulli i marimangës që thur shtëpi, e sikur ta dinin ata, më e dobëta shtëpi është e shtëpia e marimangës". (Ankebut: 41)**

Marimangat kanë luajtur rol të madh në fshehjen e Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe shoqërimit të Ebu Bekrit radiAllahu Anhu kur ata ishin në shpellën e Taurit (Thaër) në rrugën e tyre për në Medina gjatë Hixhretit (migrimit të Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, nga Meka në Medine). Marimangat bënë një rrjet dhe mbyllën hyrjen e shpellës dhe kjo i habiti armiqët të cilët e kërkonin Muhammedin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe shokun e tij. Ata menduan se marimangat e kishin bërë rrjetin e tyre shumë vjet para se të lindë i Dërguari i Allahut, Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Marimangat agjërojnë gjatë periudhës së lindjes së vezëve dhe kujdesit për to. Në këtë kohë marimangat nuk kanë asnjë lloj të ushqimit. Marimangat femra ndërtojnë çerdhet dhe fëshikëzat dhe i bëjnë vezët. Pastaj, ato mbeten aty deri në kohën e daljes së marimangave foshnja nga vezët. Kohëzgjatja e zhvillimit të vezëve ndryshon nga lloji në lloj. Mirëpo, në të gjitha rastet, kjo periudhë kalohet pa ushqim, gjë që i bën marimangat shumë të dobëta.

Nga gjëndërrat, marimangat lirojnë disa lëngje që janë të nevojshmë për t'i ushqyer të vegjëlit, të cilët nuk kanë mundësi të kërkojnë ushqim deri sa të rriten. Kështu, të vegjëlit ushqehen me këto ushqime deri sa bëhen të aftë të kërkojnë ushqim.
Në këtë kohë, marimanga femër, prish agjërimin dhe i kthehet jetës normale.

Kjo është edhe një dëshmi e manifestimit të Fuqisë së Allahut në Krijesat e Tij. Në këtë demonstrim të Fuqisë së Allahut, rastësia nuk ka vend, por kjo është e vërteta absolute e Krijimit.

**(vazhdon)**

***Përgatiti: Klubi Studentor - Shkup***

---

**Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.**

---

**Boton:**

Shoqata Qytetare

Klubi Studentor

E-mail: penastudentore@hotmail.com

